



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË

Nr. ___ prot.

Tiranë, më 16.3.2018

139/2

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1291, datë 19.12.2008.

SHOQËRISË "BIBA- X" SH.P.K
Fshati Vilhashtovë, Gosë, Kavajë.

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi "Bajram Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA (AKSEM), ISH RISHM,
Rruga "Lord Bajron", Laprakë, Tiranë.

Shoqëria "Biba -X" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1291, datë 19.12.2008, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Mali i Skrevanit", Berat.

Nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën nr.737/6, datë 10.10.2017, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me nr.730/1, datë 11.10.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1291, datë 19.12.2008, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Mali i Skrevanit", Berat, për arsye se ka ndërprerë punën pa njoftuar strukturat përgjegjëse dhe nuk ka realizuar programin e prodhimit, siç është përcaktuar në nenin 25, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.

Leja juaj është dhënë në përputhje me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerar të Shqipërisë" të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, për revokim, është i mbështetur në gërmën "c" dhe gërmën "f", të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ju njoftojmë fillimin e

procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1291, datë 19.12.2008, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Mali i Skrevanit", Berat, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë të ditur se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes së shfrytëzimit nr.1291, datë 19.12.2008, për mineral gur gëlqeror, në objektin "Mali i Skrevanit", Berat.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZËVENDËSMINISTRI

